

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 I KA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ / UROSEVAC

NË EMËR TË POPULLIT

19. 09. 20 17

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin e vetem gjykues Ilir Bytyqi dhe me sekretaren juridike

Kadishe Shabani, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR] për shkak të veprave penale: sulmi nga neni 187 par. 3 të KPRK-së, vepra penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së, vepra penale lendim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 të KPRK-së, si dhe dy veprave penale shkelja e urdhrimit mbrojtës nga neni 5, 6 dhe 7 lidhur me nenin 25 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1892-6/13 e dt. 14.01.2014, ~~PP/II.nr.1207-5/13~~ e dt. 09.08.2013, PP/II.nr.2010-1/13 e dt. 09.07.2014, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Valdet Avdiu, të pandehurit [REDAKTUAR] me datë 02 Maj 2017, mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datën 12 Maj 2017 përpiloi me shkrim këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri: [REDAKTUAR] i lindur me [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], me vendbanim në Rr. "[REDAKTUAR]" banesa nr. [REDAKTUAR], kati [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

1. Se me datën. 02.09.2013, rreth ores 00:00, në rrugën "Ahmet Kaciku" në Ferizaj, në objektin e "[REDAKTUAR]" në banesën nr 36, kati 6, pas një mosmarrveshje me djalin e tij [REDAKTUAR], fillimisht ishin fjalosur pastaj e kishte goditur me grushte në barke të demtuarin, por i njëjti nuk posedon raport mjeksor pasi ka refuzuar të shkojë te mjeku.

me të cilën kreu veprën penale sulmi nga neni 187 par. 3 të KPRK-së.

2. Se me datën 11.06.2013, rreth ores 17:00, ne benesen e tij ne rrugen "Ahmet Kaciku" ne Ferizaj, pas nje mosmarrveshje familjare, ka kanosur te demtuaren gruan e tij [REDAKTUAR] qe menjher te k'thehet ne banes "se per ndryshe do ta sulmoj ate", me cka e demtuara ishte detyruar te k'thehet, pasi eshte k'thyer e ne banes i pandehuri ka kanosur duke tentuar ta sulmoje ate dhe femijet por e demtuara kishte dal nga banesa dhe e kishte njoftuar policine.

me të cilën kreu veprën penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së.

3. Se me datën 15.06.2013, rreth ores 21:00, pas nje mosmarrveshje familjare, i pandehuri ka shkelur urdherin mbrojtës te leshuar nga Gjykata Themelore Ferizaj UM.nr.5/13, ku me kete aktvendim te pandehurit i eshte ndaluar ti afrohet te mbrojtues [REDAKTUAR] ne nje distanc prej 50 metra per shkak te dhunes se ushtruar, mirepo i njejti nuk ka respektuar urdherin e gjykates dhe eshte hasur ne banes.

me të cilën kreu veprën penale shkelja e urdherit mbrojtës nga neni 5, 6 dhe 7 lidhur me nenin 25 par. 1 të Ligjit per Mbrojtje nga Dhuna ne Familje.

4. Se me datën 16.06.2013, rreth ores 20:00, ne banesen e tij ne rrugen "Ahmet Kaciku" ne Ferizaj, i ka shkaktur lendime trupore djalit te tij [REDAKTUAR] ne ate menyre qe e ka kapur per floke dhe e ka goditur nje here me nje dote qelqi ne koke ku i demtuari ka pesuar lendim te lehte trupor, qarjre te kooes ku eshte bere qepja e plages.

me të cilën kreu veprën penale lendim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 nenpar. 3.1 lidhur me par. 1 nenpar. 1.4 të KPRK-së.

5. Se me datën 03.10.2013, rreth ores 14:30, ne objektin banesor te "Kullat Binjake" ne rrugen "Ahmet Kaçiku" ne Ferizaj, ka shkelur urdherin mbrojtës te

shqiptue nga Gjykata Themelore ne Ferizaj, ne ate menyre qe i pandehuri nuk i eshte permbajtur urdherit ashtu qe eshte vendosur ne banese.

me te cilen kreu veprën penale shkelja e urdherit mbrojtës nga neni 5, 6 dhe 7 lidhur me nenin 25 par. 1 të Ligjit per Mbrojtje nga Dhuna ne Familje.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave te sipër cekura dhe neneve 2,4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 74 dhe 81 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPR-së, e

Të pandehurit [REDACTED] i

CAKTON DËNIM

Për piken një të dispozitivit, dënim me gjobe ne shumen prej 150 Euro.

Për piken dy të dispozitivit, dënim me burg ne kohëzgjatje prej dy /2/ Muaj.

Për piken tre të dispozitivit, dënim me burg ne kohëzgjatje prej dy /2/ Muaj.

Për piken kater të dispozitivit, dënim dënim me gjobe ne shumen prej 150 Euro.

Për piken pese të dispozitivit, dënim me burg ne kohëzgjatje prej tre /3/ Muaj.

Gjykata konform dispozitës ligjore te neni 80 par 2 nenpar. 2.2 dhe 2.4 te KPRK-se, të pandehurin, e

GJYKON ME DENIM UNIK BURGIM

Në kohëzgjatje prej pesë /5/ Muaj, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Dhe

Dënim me gjobe ne shumen e përgjithshme prej 300 €, e cila gjobe nuk do të ekzekutohet në afat prej një /1/ viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nese i pandehuri nuk kryen veper tjeter penale.

Të dëmtuarit, [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR], për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest juridiko – civil.

I pandehuri [REDAKTUAR] lirohet nga shpenzimet e paushallit gjyqesor dhe shpenzimet e procedures penale pasi eshte shfrytezues i asistences sociale (kartoni social nr. registri 31002 dt. 06.10.15).

A r s y e t i m i

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzat të evidentuar PP/II.nr.1892-6/13 e dt. 14.01.2014, PP/II.nr.1207-5/13 e dt. 09.08.2013, PP/II.nr.2010-1/13 e dt. 09.07.2014, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për keto vepra penale: sulmi nga neni 187 par. 3 të KPRK-së, vepra penale kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-së, vepra penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 3 të KPRK-së, si dhe dy veprave penale shkelja e urdhrin mbrojtës nga neni 5, 6 dhe 7 lidhur me nenin 25 te Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Gjykata duke vepruar sipas detyres zyrtare por edhe me pëlqimin e prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, ka bërë bashkimin e lëndëve penale sipas nr. P.nr. 27/14, P.nr.734/14 dhe P.nr.1324/13, pasi i pandehuri eshte i njejte, natyra e veprave penale jane te njejta, dashja e njejte e kryesit si dhe per shkak te ekonomizimit te procedures penale me aktvendim të veqant konform nenit 35 par. 1 te KPPK-se.

Gjykata duke vepruar sipas këtyre akuzave caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 02.05.2016, në të cilën shqyrtim fillestar i pandehuri [REDAKTUAR] ka deklaruar: *i pranoj të gjitha pikat e aktakuzave që më ngarkojnë, si dhe shton se i vjen keqë për këto vepra penale dhe pendohem thellë, i premtom gjykatës në të ardhmen nuk do të persëriten, dhe lut ti shqiptojë një sanksion penal sa më të butë.*

Prokurori i Shtetit Valdet Avdiu, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarve, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarit tëi shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Pasi që dy të akuzuarit kanë pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar për të gjitha pikat në aktakuza, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 4 edhe përkundër paralajmërimit të të pandehurit për nenin 246 par. 1 të KPPRK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se:

- të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit, përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit [REDAKTUAR], deklaratat e të dëmtuarit [REDAKTUAR] dt. 02.09.2013, deklaratat e të dëmtueses [REDAKTUAR] dt. 15-16.06.2013, 11.06.2013, ekspertiza mjeko-ligjore dt. 20.07.2013, Aktvendimi për Urdhër Mbrojtjes dt. 08.05.2012, raporti i oficerit 03.10.2013, si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individualkonform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale lëndim i lete trupor nga neni 188 par.1 nënpar. 1.4, sulmit nga neni 187 par. 1, kanosje nga neni 185 par. 1 të KPRK-se, si dhe vepra penale shkelja e urdherit mbrojtës nga neni 25 par. 1 të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar secilin dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 187 dhe 188 arrihet në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik, të personit, cenimi i të cilit pasjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepra penale nga ligji, duhet që të kenë prekur shëndetin e personit, konkretisht funksionimin normal të trupit të të dëmtuarit, duke i sjelle atij paaftësi të përkohshme.

Në rastin konkret veprimet e dhunës duhet të sjellin si pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial e ekonomik, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale. Me integritet fizik do të kuptohet e drejta dhe mundësia që ka një person për të zotëruar dhe kontrolluar vetë trupin e tij dhe për tu ndier i sigurtë nga çdo formë e dhunës.

Nga interpretimi dispozitës të nenin 25 të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje arrihet në përfundimin se, ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe integritetit fizik të personit, cenimi i të cilit pasjell përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepra penale nga ligji, duhet që të kenë shkelur aktvendimin për urdher mbrojtës të caktuar nga gjykata kompetente.

Në rastin konkret veprimet e të pandehurit kanë sjelle si pasojë shkeljen e urdherit mbrojtës, në atë mënyrë që i pandehuri edhe perkunder faktit që i është ndaluar të ofrohet të demtuara në distancë prej 50 metrave (pika 1 e vendimit), respektivisht të largohet nga të largohet nga banesa dhe most a pengojë të demtuaren (pika 2 e vendimit), i vetedishëm dhe me dashje direkte dy here radhazi me dt. 03.10.2013 është vendosur në banesë dhe me dt. 15.06.2013 është hasur në banesë dhe i ka larguar teshat të demtuara nga dhona në korridor, rrethanë kjo cilësuese e veprës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjukata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht

lehtësuese pranimin e fajësinë, shprehjen e pendimin e sinqert dhe real për veprat penale të kryera, gjendjen e rende ekonomike, ndersa si rrethana renduese vlersoj at se i pandehuri per dia vite radhazi ka sjell probleme te natyres familjare, dhune e ushtruar ndaj antarve te familjes, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veqanarisht rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 453 par. 4 të KPPK-së, i akuzuari lirohet nga paushallit gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale pasi pagesa e tyra mund ta rrezikon gjendjen materiale per faktin se i pandehuri eshte shfrytezues i asistences sociale (bashk. Kartonin social).

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHRSHËM
P.nr.27/14, me datë 12.05.2017.**

**Sekretare Juridike
Kadishe Shabani**



Gjyqtari: Ilir BYTYQI



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.